



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 2012/4 prot.

Tiranë, më 27.10.2025

VENDIM

Nr. 36, datë 27.10.2025

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi z. (në vijim “ankuesi”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) formularin e ankesës me nr. 2012 prot., datë 07.08.2025, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Agjencia Kombëtare e Rinisë (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, me anë të kërkesës për informacion, të depozituar pranë Autoritetit Publik nëpërmjet e-mail-it të datës 22.07.2025, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni, për vitin 2024 në lidhje me:

1. Cilët janë fituesit (OJF rinore dhe OJF-të për të rinjtë) që kanë përfituar fonde publike, në kuadër të Thirrjes nr. 4 të shpallur nga AKR, si titulloheshin projektet dhe në cilat njësi administrative të vendit janë zbatuar këto projekte?
2. Sa pikë dhe çfarë vlere monetare kanë përfituar secila prej fituesve në kuadër të Thirrjes 4?
3. Cilat janë fituesit (OJF rinore dhe OJF-të për të rinjtë) që kanë fituar fonde publike në kuadër të Thirrjes nr. 5 të shpallur nga AKR, si titulloheshin projektet dhe në cilat njësi administrative të vendit janë zbatuar këto projekte?
4. Sa pikë dhe çfarë vlere monetare kanë përfituar secila prej fituesve në kuadër të Thirrjes 4?
5. Kemi interes për t’u njohur me kopjen origjinale të proces-verbalit që është depozituar në protokollin e AKR me nr. 154/8 prot., datë 13.06.2025.

Nëpërmjet e-mail-it, datë 28.07.2025, Autoriteti Publik i ka kthyer përgjigje ankuesit, duke cituar se: “...Në vijim të e-mail-it tuaj datë 22.07.2025, ju rikujtojmë se: Me anë të e-mail-it datë 17.06.2025, bazuar në VKM nr. 566, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së Organizatave Rinore dhe/ose për të Rinjtë, që përfitojnë financim nga fondet grant nga buxheti i shtetit të dedikuar për rininë”, ju jeni njohur me vendimin e Komisionit të vlerësimit për projekt-propozimin tuaj. Në datë 18.06.2025 ju keni kërkuar informacion mbi rezultatin e vlerësimit të projekt-propozimit tuaj, i cili ju është vënë në dispozicion me e-mail-in e datës 18.06.2025. Gjithashtu, më datë 20.06.2025 i jeni drejtuar Znj. Muzhaqi me një kërkesë për informacion më të detajuar mbi vlerësimin e projekt-propozimit, informacion i cili ju është vënë në dispozicion me e-mail-in e datës 23.06.2025 nga AKR. Në përgjigje të ankimimit tuaj Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ju ka vënë në dispozicion Vendimin nr. 3213/3 prot., datë 21.07.2025, i cili përmban informacion të detajuar mbi mos-përzgjedhjen për financim të projekt-propozimin tuaj. Për sa më sipër ju ri-vendosim në vëmendje se në bazë nenit 18 të VKM nr. 566 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së Organizatave Rinore dhe/ose për të Rinjtë, që përfitojnë financim nga fondet grant nga buxheti i shtetit të dedikuar për rininë”, ligjit nr. 44/2015 “Kodi Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ju konfirmojmë se keni ndjekur të gjitha hapat ligjorë për marrjen e informacionit të kërkuar, i cili ju është vënë në dispozicion brenda afateve të përcaktuara. Për sa i përket kërkesës tuaj me objekt: “Informacion për shpërndarjen e fondeve publike, në kuadër të thirrjeve nr. 4 dhe nr. 5”, ju sqarojmë se bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar, neni 17 kufizime, pika 1 “E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia informacionit dëmton interesat e mëposhtëm a) të drejtën për një jetë private; b) sekretin tregtar; c) të drejtën e autorit; ç) patentat. Kufizimi i së drejtës së informimit, për shkak të interesave të parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të kësaj pike, nuk zbatohen kur titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien informacionit përkatës ose kur në momentin e dhënies së informacionit ai është konsideruar autoritet publik në bazë të parashikimeve të këtij ligji...”, duke qënë se informacioni i kërkuar përfshin të dhëna që lidhen me organizatat përfituese, të cilat nuk kanë dhënë pëlqimin për publikimin e këtij informacioni, AKR nuk ka mundësi t’jua vërë në dispozicion këtë informacion, pasi kjo do të tejkalonte kompetencat e saj ligjore...”

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi i është drejtuar Zyrës së Komisionerit, duke kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga Autoriteti Publik.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e

mundur”, Komisioneri nëpërmjet shkresës nr. 2012/1 prot., datë 08.08.2025, ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin, apo procedurën e ndjekur, lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar, brenda datës 15.08.2025.

Autoriteti Publik, nëpërmjet shkresës nr. 342/1 prot., datë 15.08.2025, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2012/2 prot., datë 15.08.2025 i ka kthyer përgjigje ankuesit duke sqaruar se: “...Në përgjigje të Shkresës Tuaj nr. 2012/1 prot., datë 08.08.2025 “Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie të informacionit”, protokolluar me tonën nr. 342 prot., datë 12.08.2025. Në mbështetje të nenit 18 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjit nr. 119/2024 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar, pikës 6 të Kreut III të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 681, datë 02.09.2020 “Për mënyrën e krijimit, të organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR)”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 566 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së Organizatave Rinore dhe/ose Për të Rinjtë, që përfitojnë financim nga fondet grant nga buxheti i shtetit të dedikuar për rininë” si dhe të urdhrit të Kryeministrit nr. 58, datë 18.04.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Rinisë”, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon: Komisioni i vlerësimit të projekt-propozimeve i ngritur sipas Urdhrit nr. 2 datë 28.05.2025 të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët “Për ngritjen Komisionit të Vlerësimit të projektpropozimeve të përgatitura nga organizatat rinore dhe organizatave për të rinjtë me fond grant për rininë”, ka vlerësuar projektpropozimin e paraqitur nga Qendra “ABC Tirana”, “Fqinjët, Edicioni 7” me 13 pikë për kriterin e kapacitetit financiar dhe operativ, me 18 pikë për kriterin e relevancës, me 7 pikë për kriterin metodologjisë, me 8 pikë për kriterin e qëndrueshmërisë dhe 8 pikë për kriterin e buxhetit dhe efikasitetit të kostos me 55 pikë në total, referuar procesverbalit të Komisionit të Vlerësimit për Thirrjen nr. 5, Qendra “ABC Tirana” është njoftuar mbi këtë vendim sipas e-mail-it të datës 17.06.2025, nëpërmjet add të e-mail-it zyrtar të Agjencisë Kombëtare të Rinisë info@rinia.gov.al. Në vijim të njoftimit, Qendra “ABC Tirana” i është drejtuar AKR-së me një ankim datë 18.06.2025, subjekti ankimes është sqaruar me e-mail-in në vazhdimësi mbi rezultatet dhe komentet për këtë projektpropozim dhe çdo pretendim tjetër të ngritur mbi procesin e vlerësimit të projektpropozimit. Në vëmendje të subjektit ankimes është vënë re se, në bazë të Nenit 9, të VKM-së nr. 566 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së Organizatave Rinore dhe/ose Për të Rinjtë, që përfitojnë financim nga fondet grant nga buxheti shtetit të dedikuar për rininë”, vlerësimi i projekt-propozimeve të paraqitura për Thirrjen publike kryhet nga Komisioni i Vlerësimit, i ngritur për këtë qëllim dhe jo nga Agjencia Kombëtare e Rinisë, e cila në bazë të Nenit 8, pika 8, të VKM-së të sipërpërmendur, ushtron detyrën e sekretariatit të Komisionit të Vlerësimit dhe nuk vlerëson apo shprehet mbi vendimmarrjen e Komisionit. Gjithashtu ankuesi në pretendimet e veta thekson se mungon fondi total në dispozicion të kandidatëve për Thirrjen 5 për projekt-propozime të AKR-së. Referuar dokumentacionit të aplikimit, përkatësisht shtojcës 1 “Përshkrimi i Thirrjes”, nën seksionit “Fondi (Grantet) në dispozicion për financimin e projektpropozimeve”, fq. 4, ku përcaktohet se: “...Totali i grantit për mbështetjen e organizatave

rinore dhe/ose për të rinjtë në këtë thirrje është 90.000.000 Lek...”. Shtojca rezulton e publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Rinisë, më datë 28.04.2025 në kuadër të shpalljes së Thirrjes V “Për projekt-propozime nga organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë”. Ankuesi në pretendimet e veta thekson se mungon informacioni mbi kandidatin e shpallur fitues që ka akumuluar totalin e pikëve më të ulta, sipas vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit. VKM-ja nr. 566 datë 29.07.2022, përcakton në pikën 1, të nenit 16 se: “...AKR-ja, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e miratimit të procesverbalit të vlerësimit të projektpropozimeve, publikon në faqen zyrtare të saj informacion mbi vlerësimin e projektpropozimeve...” dhe përcakton në pikën 4, të nenit 17 se: “...Agjencia Kombëtare e Rinisë, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të procesit të vlerësimit, përfundon procedurën e negocimit me çdo kandidat të përzgjedhur për financim dhe përcjell për miratim pranë ministrit përgjegjës për rininë listën e rishikuar me projektet fituese, përshkrimin e projekteve dhe shumat përfundimtare të granteve për financim...”. Referuar përcaktimeve të VKM-së nr. 566 datë 29.07.2022, Agjencia Kombëtare e Rinisë do të publikojë në faqen e zyrtare të internetit rinia.gov.al, listën me projekt-propozimet e vlerësuara dhe të pikëzuara, në kuadër të thirrjes Nr. V “Për projekt-propozime nga organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë”, pas përfundimit të procedurave administrative të vlerësimit, negocimit dhe ankimimit dhe miratimit përfundimtar të procesverbalit të vlerësimit nga ministri. Për sa më sipër subjektit ankimes gjithashtu i është dërguar Vendimi nr. 3213/3 prot., datë 21.07.2025 i Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, ku shprehet qartë “Lënia në fuqi të vendimit të Komisionit të Vlerësimit të projekt-propozimeve për mospërzgjedhjen për financim të projektpropozimit “Fqinjët, Edicioni i 7” paraqitur nga Qendra “ABC TIRANA CLUB” në procesin e vlerësimit të Thirrjes nr. V të AKR-së dhe pikëzimin përfundimtar të tij me 55 pikë, si dhe detajimi i të gjitha pretendimeve të ankimesit. Për sa më sipër bashkëngjitur do të gjeni dokumentacionin shoqërues: 1- Projektet Fituese të Thirrjes së pestë të shpallur nga Agjencia Kombëtare e Rinisë për projektet rinore nga organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë; 2- Projektet Fituese të Thirrjes së katërt të shpallur nga Agjencia Kombëtare e Rinisë për projektet rinore nga organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë; 3- Vendimin nr. 3213/3 prot., datë 21.07.2025 i Ministres së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët; 4- Komunikimin e vazhdueshëm me e-mail me subjektin ankimes...”

Pas përgjigjes së sipërcituar të Autoritetit Publik, ankuesi ka depozituar vijimin e ankimit, nëpërmjet e-mail-it të datës 19.08.2025, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2012/3 prot., datë 20.08.2025, duke i qëndruar kërkesës për informacion të datës 22.07.2025.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i Autoritetit Publik nuk është në përputhje me dispozitat e LDI, si dhe detyrimet që burojnë nga ky i fundit.

Nga shqyrtimi i çështjes, konstatohet se objekti i kërkesës lidhet me përfitime të fondeve publike në zbatim të vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 566 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së Organizatave Rinore

dhe/ose Për Të Rinjtë, që përfitojnë financim nga fondet grant nga buxheti i shtetit të dedikuar për rininë”, të përfituara nga Organizata Rinore ose Organizata për të Rinjtë nëpërmjet thirrjeve publike të kryera nga Autoriteti Publik/Agjencia Kombëtare e Rinisë. Bazuar në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj*”. Në kuptim të këtij parashikimi, Agjencia Kombëtare e Rinisë është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë është vetë ky autoritet që detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të munduruar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në pikën 1 të nenit 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e “prodhuesit” apo “mbajtësit” të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.*

Konstatohet se, Autoriteti Publik në përgjigjen e kthyer ankuesit nëpërmjet e-mail-it të datës 28.07.2025: *“...bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar, neni 17 kufizime, pika 1 “E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia informacionit dëmton interesat e mëposhtëm a) të drejtën për një jetë private; b) sekretin tregtar; c) të drejtën e autorit; ç) patentat. Kufizimi i së drejtës së informimit, për shkak të interesave të parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të kësaj pike, nuk zbatohet kur titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien informacionit përkatës ose kur në momentin e dhënies së informacionit ai është konsideruar autoritet publik në bazë të parashikimeve të këtij ligji...”, duke qënë se informacioni i kërkuar përfshin të dhëna që lidhen me organizatat përfutuese, të cilat nuk kanë dhënë pëlqimin për publikimin e këtij informacioni, AKR nuk ka mundësi t’jua vërë në dispozicion këtë informacion, pasi kjo do të tejkalonte kompetencat e saj ligjore...”* vjen si keq interpretim i ligjit, pasi Autoriteti Publik nuk ka konsideruar faktin se në zbatim të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, organizatat funksionojnë në disa forma të parashikuara në nenet 9 e vijues të ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i ndryshuar dhe të cilat e fitojnë këtë status pas depozitimit të akt-themelimit dhe statutit në gjykatë, sipas parashikimeve të nenit 4 e vijues, të ligjit nr. 80/2021 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”.

Shprehimisht ligji nr. 80/2021 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, në nenin 38, parashikon se: *“1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë publikon në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Regjistrimit, që mbahet nga sekretaria e regjistrit, në format elektronik dhe në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në çdo rast të regjistrimit ose të ndryshimit të të dhënave në regjistër të dhënat e mëposhtme: a) emrin; b) formën e organizimit; c) datën e themelimit; ç) qëllimin dhe fushën e*

veprimtarisë; d) kohëzgjatjen, në qoftë se është e përcaktuar; dh) emrin e përfaqësuesit ligjor; e) numrin unik të identifikimit. 2. Sekretaria e regjistrat elektronik kryen publikimin në buletin brenda 1 (një) dite nga data e kryerjes së regjistrimit. Për çdo publikim përcaktohet qartë data në të cilën është regjistruar e dhëna e publikuar. 3 Publikimi në Buletin e Njoftimeve Zyrtare të Regjistrimit përbën publikim zyrtar të regjistrimeve, të kryera në kuptim të nenit 7 të këtij ligji. 4. Publikimi i të dhënave sipas këtij neni kryhet në përputhje me kufizimet e vendosura nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.”

Vetëm pas marrjes së formës së prerë të vendimit nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, kryhet regjistrimi me numrin unik të identifikimit, pranë administratës tatimore.

Legjislacioni i mësipërm përjashton qartazi organizatat nga parashikimet e pikës 1 të nenit 17 të LDI, a) të drejtën për një jetë private, b) sekretin tregtar, c) të drejtën e autorit dhe ç) patentat. Gjithashtu, Autoriteti Publik nuk ka argumentuar në zbatim të parashikimeve të nenit të sipërcituar se cila nga pikat e mësipërme cenohet duke u publikuar emri i organizatës e cila ka përfituar/fitur thirrjen. Në çdo rast, duke qenë se informacioni i kërkuar lidhet me përfitime nga buxheti i shtetit, interesi publik për të aksesuar informacionin/dokumentacionin e kërkuar, në këtë rast është i drejtëpërdrejtë dhe tejet i lartë.

Në këtë analizë, Komisioneri vlerëson se, bazuar në pikën 6 të nenit 17 të LDI, sipas të cilit parashikohet se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*, Autoriteti Publik, duhet të kishte vlerësuar kufizimin e pjesëve të dokumentacionit të kërkuar, të cilat sipas gjykimit të tij i nënshtrohen kufizimeve të trajtuara më sipër, duke vënë në dispozicion të kërkuarit pjesën tjetër të informacionit.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, dokumentacioni i kërkuar, në parim përbën informacion publik bazuar në pikën 2, të nenit 2, të LDI sipas të cilës: *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse është prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të këtij ligji, i cili parashikon: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike. Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke*

marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së z. _____, me nr. 2012 prot., datë 07.08.2025, ndaj Autoritetit Publik, Agjencia Kombëtare e Rinisë me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 22.07.2025, konkretisht: “ 1. Cilët janë fituesit (OJF rinore dhe OJF-të për të rinjtë) që kanë përfituar fonde publike, në kuadër të Thirrjes nr. 4 të shpallur nga AKR, si titulloheshin projektet dhe në cilat njësi administrative të vendit janë zbatuar këto projekte? 2. Sa pikë dhe çfarë vlere monetare kanë përfituar secila prej fituesve në kuadër të Thirrjes 4? 3. Cilat janë fituesit (OJF rinore dhe OJF-të për të rinjtë) që kanë fituar fonde publike në kuadër të Thirrjes nr. 5 të shpallur nga AKR, si titulloheshin projektet dhe në cilat njësi administrative të vendit janë zbatuar këto projekte? 4. Sa pikë dhe çfarë vlere monetare kanë përfituar secila prej fituesve në kuadër të Thirrjes 4? 5. Kemi interes për t’u njohur me kopjen origjinale të proces-verbalit që është depozituar në protokollin e AKR me nr. 154/8 prot., datë 13.06.2025.”, brenda datës 03.11.2025.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 27.10.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi